

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË “Trinity Construction” Sh.P.K.**

Sot më datë 29.07.2024, palët e mëposhtme:

- **Z. Xhulian Hysollari**, i biri i Eqeremit, i datëlindjes 25.02.1994, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë me mjet identifikimi me numër **J40225094J**

shprehin vullnetin e tyre për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**Trinity Construction**” Sh.P.K. si më poshtë vijon:

**1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria “**Trinity Construction**” Sh.P.K., nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

**2. Ortakët themelues**

Shoqëria është themeluar nga Ortakët e mëposhtëm:

- **Z. Xhulian Hysollari** me numër identifikimi (NID) **J40225094J**

**3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Trinity Construction**” Sh.P.K. do të jetë:

- Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale
- Punime të specializuara ndërtimi
- Punime elektrike, hidraulike dhe të tjera punime instalimi
- Punime të tjera të specializuara ndërtimi
- Çdo lloj veprimtarie të ligjshme që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.

**4. Selia e shoqërisë**

Selia e Shoqërisë “**Trinity Construction**” Sh.P.K. do të jetë në Tiranë, në adresën: Njësia administrative nr. 10, rruga e Kavajës, ndërtesa nr. 116, Ish qendra Gurten, Tiranë.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.



## 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## 6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **“Trinity Construction” Sh.P.K.** është 10000 Lekë i ndarë në 1 kuotë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues dhe do të paguhet nga ortakët që zotërojnë 100% (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:

- **Z. Xhulian Hysollari**, i biri i Eqeremit, i datëlindjes 25.02.1994, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë me mjet identifikimi me numër **J40225094J**, i cili zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.


## 7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **“Trinity Construction” Sh.P.K.** është **Z. Xhulian Hysollari** me numër identifikimi (NID) **J40225094J**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **“Trinity Construction” Sh.P.K.** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.



## 8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakuj ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

### Ortakët

**Xhulian Hysollari (J40225094J)**

XHULIAN HYSOLLARI

